



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20 Ref.: 967/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, nga 01.09.2020 deri me 30.10.2023.
- II. Obligohet Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" që deri me datë 1 tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtar të akreditimit në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional vizita është realizuar me 18.05.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Yelena Istileluova, University of Ljubljana, Prof. Dr. Elene Jibladze, Ilia State University, Ms. Delia Gologan, student.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" ka përmbush substancialisht standardet të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsej njëmbëdhjetë (11) kapituj të standardeve të Manualit të Akreditimit, Universiteti i Mitrovicës nga to plotëson: Substancialisht (8) Deklarata e Misionit dhe Objektivat Institucionale; Planifikimin strategjik, qeverisjen dhe administrimin; Planifikimi dhe menaxhimi financiar; Menaxhimi i Cilësisë; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Burimet dhe

infrastruktura; Bashkëpunimi institucional. Plotëson pjesërishtë: (3) Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Mësimdhënia dhe Mësim marrja; Hulumtimi;

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Superior të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.